

E.C.M.A. WARSHE



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-45732
Më 10.3.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e shtatë (7) projekteve kapitale dhe mori këtë:

KON KLuzion

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të shtatë (7) projekteve kapitale, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:
 - 1.1. Rrugëve lokale në fshatin Velezhë,
 - 1.2. Rrugëve lokale në fshatin Lubizhdë e Prizrenit,
 - 1.3. Rrugës në lagjen “Boka”,
 - 1.4. Rregullimin e shtratit të lumit në Landovicë,
 - 1.5. Rrugës dhe kanalizimit në lagjen “Gurishta”, në Zhur,
 - 1.6. Rrugës së vjetër në Jeshkovë dhe
 - 1.7. Rrugës “Anton Pashku”.
2. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
3. Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.
4. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja